



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “IMK Ballkan Projekt” Sh.P.K. të datës 27.09.2023 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Shërbime laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore” me nr. të prokurimit 616-22-14438-2-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e **pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “IMK Ballkan Projekt” Sh.P.K. të datës 27.09.2023 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Shërbime laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore” me nr. të prokurimit 616-22-14438-2-2-1.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “IMK Ballkan Projekt” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “IMK Ballkan Projekt” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 27.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Shërbime laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore” me nr. të prokurimit 616-22-14438-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim: “*ju ne arsye e anulimit te ketij aktiviteti te prokurimit keni cekur se nuk jane plotesuar te gjitha kushtet teknike dhe profesionale lidhur me ofrimin e deshmive se jane perfundur me sukses kontrata te ngjashme ne vlere min. 150,000.00 EUR, ne tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit per Kontrate. Lidhur me arsye tuaj te eliminimit, ju sqarojme se arsyetimi i juaj per anulim te ketij aktiviteti nuk qendron sepse ne si OE kemi ofruar kontrata ne vlere mbi 150,000.00 EUR, pra e kemi tejkeluar kete kerkese tuaj”.*

Fillimisht duhet sqaruar se kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohen pretendimet ankimore është formuluar si në vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
I. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, ne vlere minimale prej 150,000 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).	I. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.


Sa i përket pretendimeve ankimore duhet sqaruar se nga dosja e dokumenteve me të cilën ka ofertuar parashtruesi ndër të tjera është dorëzuar edhe lista e kontratave të realizuara sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit. Megjithatë nga referencat ose certifikatat për kryerjen e punimeve të listuara në këtë formular të aneksit 6 rezulton se nuk është arritur vlera minimale prej 150,000.00 euro në tri vitet e fundit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit.

Prandaj parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.